

PYETJET QË BËHEN VAZHDIMISHT (FAQ)

Në New York prindërit duan të dijnë rreth Standardeve të Shtetit "Common Core" (Common Core State Standards). Më poshtë janë disa pyetje dhe përgjigje që bëhen vazhdimisht lidhur me këto standarde. Këto do të ndryshojnë me kalimin e kohës. Ju lutem të kontaktoni mësuesin e fëmijës ose drejtorin e shkollës për të mësuar më tepër mbi punën e shkollës lidhur me standartet "Common Core".

Pyetja. Çfarë janë Standartet e Shtetit "Common Core"?

Përgjigje. Standartet e Shtetit "Common Core" tregojnë se çfarë studentët në sistemin parashkollor deri në klasën e 12-të duhet të dijnë dhe të bëjnë gjatë studimeve të kultures së gjuhës angleze si dhe matematikës. Standartet do të ndihmojnë të gjithë nxënësit e New Yorkut të mësojnë të njëjtat aftësi. Këto do të sigurojnë që nxënësit të jenë të gatshëm për kolegjin dhe karrierën. Standartet përfshijnë ndryshimin ose "ndryshimet" në mënyrën se si mësuesit u mësojnë fëmijëve të kenë sukses në fushat dhe aftësitë që kanë më shumë rëndësi. Standartet janë hartuar të ndihmojnë të gjithë rinjtë të jene të përgatitur për kolegjin dhe karrierën.

Pyetja. A nënkupton zbatimi i Standardeve "Common Core" faktin që secili do të mësojë më pak?

Përgjigje. Jo. Standartet e Shtetit "Common Core" janë ndërtuar mbi bazën e standardeve më të mira që shtetet i kanë marrë në të gjithë vendin, nga kombet e tjera si edhe nga puna e gjerë kërkimore mbi atë që nevojitet për të patur sukses në punë dhe në studimet e larta. Standartet "Common Core" u kërkojnë mësuesve të hulumtojnë më thellë në aftësitë kryesore dhe konceptet në çdo klasë. Kjo nënkupton që nxënësit do të mësojnë më shumë rreth më pak temave. Po ashtu, kjo nënkupton që mësuesit do të kenë më shumë kohë për të trajtuar lëndët më në detaj. Kjo i jep mundësi nxënësve që të kuptojnë më mirë lëndën që u mësohet.

Pyetja. A i tregojnë standartet mësuesve se si të japin mësim?

Përgjigje. Jo. Standartet janë një mënyrë që ndihmon mësuesit të përgatisin mësimet dhe aktivitetet më të mira në klasë. Po ashtu, standartet ndihmojnë nxënësit dhe prindërit të kuptojnë se çfarë u kërkohet që të kenë sukses në çdo klasë. Standartet janë një referencë e rëndësishme për mësuesit, nxënësit dhe prindërit.

Pyetja: Si u zhvilluan standartet?

Përgjigje: Dyzet e gjashtë shtete mblodhën ekspertët, mësuesit dhe kërkuesit për të shkruajtur standartet e shtetit "Common Core" së bashku me rreth 10,000 komente dhe sugjerime, shumë prej të cilave të mbledhura nga mësuesit dhe prindërit e New Yorkut. New Yorku i miratoi standartet në vitin 2010. Standartet u përshtaten mirë klasave dhe do të ndihmojnë studentët të mësojnë më shumë. Për të lexuar të gjitha standartet ju lutem vizitoni faqen në internet <http://corestandards.org/the-standards>.

Pyetja. A nënkupton kjo më shumë provime?

Përgjigje. Jo. Standartet e shtetit "Common Core" nuk nënkuptojnë më shumë provime. Por do të ketë provime të ndryshme më të mira. Duke filluar nga muaji Prill 2013, vlerësimet e shtetit të New Yorkut do të testojnë aftësitë dhe njohuritë "Common Core" të nxënësve nga klasa e tretë deri në klasën e tetë në kulturën e gjuhës angleze dhe matematikë. Provimet e reja do të reflektojnë ndryshimin ose "ndryshimet" e standardeve. Provimet do të sigurojnë që nxënësit përmbushin arritjet e kërkuara nga klasa e tyre.

Pyetja. A do të jenë provimet e reja më të vështira?

Përgjigje. Provimet e reja mund të duken më të vështira në fillim dhe kjo është normale. Provimet e reja do të bazohen tek "ndryshimet" e standardeve. Me kalimin e kohës, nxënësit dhe mësuesit do t'ju përshtaten pritshmërive më të qarta. Po ashtu, ka mundësi që notat e nxënësve mund të ulen gjatë vitit të parë dhe të dytë të administrimit të provimeve të reja. Megjithatë, provimet janë një mjet i rëndësishëm për të përmirësuar arritjet e nxënësve. Provimet e reja do të ndihmojnë drejtuesit e shkollave dhe mësuesit të identifikojnë nxënësit që mund të kërkojnë më tepër mbështetje për të kaluar në klasën tjetër.

Pyetja. Çfarë nënkupton kjo për nxënësit e paaftë dhe ata që studiojnë në gjuhën angleze?

Përgjigje. Standardet do të ndihmojnë mësuesit të kenë më shumë kohë për të shpjeguar lëndët më në detaj. Kjo u mundëson nxënësve të kuptojnë mire lëndën që u mësohet. Ka një udhëzues të qartë për zbatimin e standardeve mbi nxënësit e paaftë dhe ata të gjuhës angleze. Po ashtu, të gjitha shtetet do të punojnë së bashku për tu përmirësuar vazhdimisht në këtë drejtim. Kjo do të sjellë si pasojë zbatimin e një sistemi më të fortë që mbështet të gjithë nxënësit.

Pyetja. Çfarë nënkuptojnë standardet e shtetit "Common Core" për nxënësit në të gjithë vendin?

Përgjigje. Standardet caktojnë prishmëritë e qarta që u kërkohen nxënësve në të gjithë vendin. Në të kaluarën, çdo shtet ka patur standardet akademike të ndryshme. Kjo nënkuptonte që nxënësit në Shtetet e Bashkuara po mësonin në mënyrë të pabarabartë konceptet dhe aftësitë e ndryshme. Standardet e shtetit "Common Core" u japin mundësi të barabartë të gjithë nxënësve të New Yorkut të mësojnë me të njëjtat standarde të larta. Kjo mundëson arritjen e suksesit më të madh në kolegji, karrierë dhe jetë.

Pyetja. Nëse standardet rriten, a ka mundësi që nxënësit të braktisin shkollën?

Përgjigje. Nuk ka gjasa që nxënësit të braktisin shkollën. Studimet kërkimore tregojnë se shumë faktorë konsiderohen që shkaktojnë një nxënës të braktisë shkollën. Po ashtu, studimet tregojnë se studentët kërkojnë të sfidohen më shumë në shkollë. Për shembull 7 nga 10 të rinj që kanë braktisur shkollën përmendën se nuk ishin të inspiruar ose motivuar për të punuar shumë gjatë shkollës së mesme. Dy të tretat e personave që kanë braktisur shkollën thanë se do të kishin punuar më shumë nëse do t'ju ishte kërkuar prej tyre (si për shembull arritjen e rezultateve më të larta akademike, të studiuarit më shumë ose bërjen e më shumë detyrave të shtëpise).¹

Pyetja. Me miratimin e standardeve "Common Core" në kulturën e gjuhës angleze dhe matematikë, a do t'ju kufizohet nxënësve mundësia e studimit në fusha të tjera si për shembull edukimi në fushën e artit, karrierës dhe atij teknik?

Përgjigje: Jo. New Yorku e kupton rëndësinë që kanë të gjitha lëndët në përgatitjen e nxënësve për arritjen e suksesit përtej shkollës së mesme. Kryerja e shkollës nga nxënës të përgatitur është i rëndësishëm për të ardhmen e New Yorkut. Standardet më të qarta të "Common Core" do të ndihmojnë mësuesit që të integrojnë mësimin në të gjitha lëndët. Kjo nënkupton që nxënësve do t'ju ofrohen mësimet që përmbajnë matematikën, shkencën, studimet shoqërore, kulturën e gjuhës angleze si dhe lëndët e tjera.

Pyetja: A penalizojnë standardet e shtetit "Common Core" nxënësit e shkollave me ecure të ngadaltë duke caktuar kërkesa të larta jo-realiste?

Përgjigje. Jo. Shumë shpesh nuk pritet shumë nga nxënësit që studiojnë sot në shkollat me ecure të ngadaltë. New Yorku ka miratuar standardet e shtetit "Common Core" që të gjithë nxënësit të përfitojnë një arsimit të shkëlqyer.

Fjalori:

- Ndryshim – Një ndryshim në mënyrën se si mësuesit japin mësim dhe nxënësit mësojnë
- Provim – Çdo detyrë me shkrim
- Jo trillues – Librat mbi faktet dhe ngjarjet reale
- Fakt – Pjesë të fakteve nga libri
- Argumentet – Si nxënësit e bindin dikë për një fakt
- Vendim – Konkluzioni i nxënësit rreth asaj që ka lexuar
- Fokusi – Të mësuarit më shumë në disa fusha
- Shpejtësia dhe përpikmëria – Sa shpejt mundet që nxënësi të zgjidhë veprimet matematikore në mënyrë korrekte

Burimet:

- Iniciativa e standardeve të shtetit "Common Core" <http://www.corestandards.org/>
- Këshilli i Shkollave të Qytetit të Madh: <http://www.cgcs.org>
- AngazhoNY: www.engageny.org
- PTA Kombëtare: <http://pta.org>

¹ Ndërmarrjet Civile. *Epidemia e qetë: Perspektivat e Braktisjes së Shkollës së Mesme*, Mars 2006.
<http://www.saansys.org/uploads/content/TheSilentEpidemic-ExecSum.pdf>